



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE

Në bazë të nenit 16 dhe 17 të Ligjit nr.03/L-087, për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "KRM Pastrimi", në Komunën e Podujevës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2020, shpallë këtë:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtari në Bordin e Drejtoreve të "KMR Pastrimi" Sh.A.Prishtinë.

Mandati i anëtarëve të bordit është në përputhje me Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009.

KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përbush edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale si në vijim:

- Të jetë person që ka integritet të njojur, duke marrë parasysh, ndër të tjera çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilit do person tjetër;
- Duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulentë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njojurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesiioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

Kandidati nuk mund të zgjidhen në bordin e NP-së, nëse:

- Aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilës do nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatës ose cilës do nga filialet e saj brendaa pesë (5) viteve të fundit.
- Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së, përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të fundit.
- Aktualisht ka ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorët.

- d) Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjeter juridik i cili ka marrëdhënje materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilën do nga filialet e saj.
- e) Pranon ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilës do nga filialet e saj).
- f) Mban drejtor si të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjera të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe.
- g) Përfaqëson një aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse.
- h) Ka shërbyer në bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parete tij/saj.
- i) Është i afërm i shkallës së tretë siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar", në nenin 2 të këtij ligji i cilit do pëson që i takon cilës do nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b).
- j) Është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare të pa listuar dhe që konkuron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të të drejtave të votimit), i ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilën do nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen.
- k) Është ose në çfarëdo kohe gjatë periushës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike.
- l) Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

Dokumentacioni për procedurën e konkurrimit

Kandidatët për drejtor në Bordin e Drejtorëve të NPL-së, duhet t'i dorëzojnë provat e më poshtme:

- CV-në
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata kompetente
- Kopje të letërnjoftimit

Çdo informatë e pa vërtetë materiale qoftë e qëllimshme apo nga neglizhenca do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në kopje në zarf të mbyllur, origjinali duhet të prezantohet gjatë intervistimit.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas këtij konkursi do të kualifikohen për fazat e mëtejme.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, kati përdhes në ndërtesën e re të Komunës, rr.”Nuhi Gashi” si dhe mund të shkarkohen në ueb faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Aplikuesi/ja duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmblush kushtet e kualifikimit pavarësinë dhe përgatitjen profesionale. Çdo përgënjeshtrim material qoftë i qëllimshëm apo nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultojë me diskualifikim të menjëhershëm.

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë pune nga data e publikimit të konkursit, përkatësisht nga data 23.11.2020 – 07.12.2020.

Datë: 23.11.2020

Komisioni Komunal i Aksionarëve

1. Faik Muçiqi
2. Liriona Shabani
3. Afrim Shabani

